

# ANALIZË E SHKURTË

## POLITIKE, KOSOVË



Konrad  
Adenauer  
Stiftung

Në këtë analizë të politikave, do të trajtohet procesi i deritashëm i integritit të Kosovës drejt BE-së, me theks të veçantë në ndikimin që mund të ketë MSA në këtë kontekst. Sfidat dhe perspektiva e Kosovës sikurse dhe rajonit në këtë rrugëtim, do të ekzaminohen po ashtu.

Nëntor 2013

[www.kas.de/kosovo](http://www.kas.de/kosovo)

## **Kosova dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit**

**Perspektiva dhe sfidat në procesin e Integritit**

**Bekim Baliqi, Ph.D**  
Universiteti i Prishtinës

## 1. Hyrje

Termi Evropë dhe evropian janë bërë pjesë e pandashme diskursit dhe fjalimeve politike, emërtimeve të ndryshme të organizatave joqeveritare, ndërmarrjeve afariste e deri të institucioneve të ndryshme arsimore. Kjo shpeshherë përdoret si sinonim i ardhmërisë dhe në mënyrë të qartë paraqet dëshirën e nevojën që shoqëria kosovare të jetë pjesë e Bashkimit Evropian. Madje edhe vet simbolet e Bashkimit Evropian kanë qenë pike referimi për krijimin e simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës, duke u nisur nga flamuri, stema dhe himni. Për më shumë selia e Qeverisë së Kosovës është vetëm pak metra larg selisë së BE-së në Prishtinë. Përkundër kësaj, procesi i integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian nuk varet as nga aspiratat politike e shoqërore, as nga ngjashmëritë simbolike e as nga afërsia e institucioneve përkatëse. Por, është një proces i ndërlikuar e kompleks që kërkon përkushtim dhe përbushjen e kritereve shumta dhe arritjeve të standardeve të kërkuara.

Vet historiku i krijimit dhe konsolidimit të Bashkimit Evropian është një proces i gjatë dhe i mundimshëm, dhe problemet, krizat e divergjencat që shfaqen kohë pas kohe brenda vet shteteve anëtarë të BE-se bëjnë që në rrafshin shkencor Bashkimi Evropian zgjon gjithnjë e më shumë interesim akademik. Sukseset e BE-së si në planin ekonomik e politik e ashtu edhe me zgjerimin e vazhdueshëm ka zgjuar interesim të madh për anëtarësim nga shtetet e reja.

Kështu shtetet e Evropës Juglindore të dala nga regjimi komunist dhe shumica të dala nga luftërat e përgjakshme mbeten ndër vendet e fundit në kontinentin evropian të cilat nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian. Pasojat e komunizmit si dhe shkatërrimet nga luftërat vështirësuan dhe ngadalësuan tranzicionin dhe procesin e avancimit të vendeve ballkanike në rrugëtimin e tyre drejt BE-së. Përpjekjet për integritin në BE nga qeveritë e këtyre shteteve gjatë dekadës së fundit janë intensifikuar dukshëm. Arsyeja kryesore që po i shtyn qeveritë drejt aplikimit për anëtarësim në BE, është arritja e nivelit të lartë të demokracisë, të arriturat ekonomiko, mirëqenia sociale të një shteti evropian. Mirëpo, jo rrallë pas kësaj aspirote

fshihen edhe përfitimet e manipulimet politike nga partitë apo qeveritë e shteteve kandidate, të cilat e shfrytëzojnë procesin e integritit për qëllime të caktuara politike.

Bashkimi Evropian është prezent në këtë rajon në forma të ndryshme, duke përkrahur fuqishëm përpjekjet e tyre për integritim në BE. Megjithatë, mungesa e një politike konsistente të BE-së karshi Evropës juglindore apo Ballkanit perëndimor siç njihet edhe ndryshe, por edhe mosmarrëveshjet e ndryshme ndërmjet vet shteteve ballkanike, ka bërë që procesi i integritit të varet si nga faktorët e brendshëm ashtu edhe nga ato të jashtme.

Kosova, si shteti më i ri në Evropë është edhe e fundit si shtet kandidatë potencial për anëtarësim sikurse edhe në përgjithësi në procesin e integritit. Kjo vjen si rrjedhojë e disa arsyejeve, së pari të moszgjidhjes së statusit juridik të Kosovës për një kohë të gjatë, pastaj të kontestit të hapur me Serbinë dhe ndikimin e saj në pjesën veriore të vendit, mosnjohjes së vendit nga pesë shtete anëtare të BE-së si dhe faktorëve si sundimit të dobët të ligjit, shkallës së lartë të korrupsionit, nepotizmit, kriminit të organizuar dhe zhvillimit të ulët ekonomik. Sidoqoftë, Kosova ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me BE-në dhe viteve të fundit ka arritur të bëjë hapa të rëndësishme në procesin e integritit. Një ndër këto arritje është padyshim përafrimi i Kosovës në rumbullakimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, si një parakusht thelbësor në procesin e anëtarësimit në BE.

Në këtë studim të shkurtë, do të trajtohet procesi i deritashëm i integritit evropian të Kosovës, me theks të veçantë në ndikimin që mund të ketë Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në rrugëtim. Cila do të jetë perspektiva sikurse edhe sfidat e Kosovës dhe të rajonit në këtë proces? Sa do të ndikoj kjo, në përbushjen e kritereve si dh përafrimin e vendit drejt BE-së? Këto janë vetëm disa nga pyetjet themelore që do të synojmë t'i japim përgjigje në këtë analize të politikave.

## 2. BE-ja dhe zgjerimi

Ashtu siç u theksua më herët trajektorja e krijimit dhe konsolidimit të BE-së është mjaft e gjatë. Ky rrugëtim fillon me krijimin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut më 1951 nga gjashtë anëtarë si Belgjika, Gjermania Perëndimore, Luksemburgu, Franca, Italia dhe Holanda, e deri te Traktati i Mastrohtit më 1992 që vuri themelet e Bashkimit Evropian që i dha një qasje ekonomike, politike dhe juridike asaj. Në vitet në vijim BE-ja nuk u plotësua vetëm me traktate të reja që e fuqizonin atë por u shtua edhe me shtete anëtarë të reja. Bashkimi Evropian nuk është thjeshtë një organizatë ndërkombëtare, ku ndodh bashkëpunimi shumëpalësh ndërmjet qeverive të shteteve sovraane të njohura, të cilat ia delegojnë BE-së disa aspekte të pushtetit vendimmarrës, por ajo megjithëkëtë nuk është as një shtet unik federal. Prandaj Bashkimi Evropian është unik si në mënyrën e funksionimit të vet ashtu edhe si entitet politik në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare<sup>1</sup>.

Njëra ndër politikat më të suksesshme të Bashkimit Evropian mund të thuhet se ishte dhe mbetet politika e zgjerimit. Sukseset e BE si në konsolidimin e vet politik e institucional ashtu edhe me zgjerimin, ka zgjuar interesim në shume disiplina akademike, duke u analizuar nga këndvështrimi ekonomik, politik, juridik, kulturor e social.

### 2.1 Procesi dhe kriteret e zgjerimit

Zgjerimi i vazhdueshëm i Bashkimit Evropian, nga 6 shtete themeluese në 28 shtete anëtare sa numëron sot, ka bere që edhe procedurat e anëtarësimit në BE të ndryshojnë dukshëm në krahasim me procedurat në fillim të veprimit të saj si organizatë regjionale. Zgjerimi i BE-së pati fillimisht dimension ekonomik duke vazhduar në atë politik dhe përforcuar gradualisht edhe themelet e veta institucionale dhe ato legale. Sipas Traktatit të Bashkimit Evropian (i njohur si i Mastrohtit), çdo shtet evropian mund të aplikojë për anëtarësim në qoftë se i respekton parimet e lirisë, demokracisë, të drejtat e njeriut

dhe liritë e përgjithshme, sikurse edhe rendin dhe ligjin. Sidoqoftë, pranimi mund të bëhet vetëm nëse vendi i caktuar i plotëson të gjitha kriteret e pranimit, të njohura si Kriteret e

Kopenhagës që në vitin 1993 janë caktuar nga Këshilli Evropian në Kopenhagë, si:

- Kriteret politike; institucione stabile që garantojnë demokraci, rend dhe ligj, të drejtat e njeriut dhe respektin e mbrojtjes së minoriteteve;

- Kriteret ekonomike; funksionim i ekonomisë së tregut dhe kapacitete për t'u përballuar me konkurrencën dhe me forcat në treg në BE;

- Kapacitetet për të qenë të gatshëm për pranimin e obligimeve të cilat dalin për anëtarë, duke përfshirë edhe arritjen e objektivave politik ekonomike dhe monetare të BE-së.

- Kriteret e Kopenhagës janë përmirësuar nga Këshilli Evropian në Madrid në vitin 1995, me miratimin e "acquis communautaire" e që nënkupton legjislacionin e përgjithshëm evropian, dhe zbatimin e tij efektiv me anë të strukturave përkatëse administrative dhe juridike<sup>2</sup>.

Shteti, që dëshiron të anëtarësohet në BE, e dorëzon aplikacionin për anëtarësim pranë Këshillit, i cili kërkon nga Komisioni ta vlerësojë aftësinë (kompetencën) e aplikuesit për t'i përmbushur kushtet e anëtarësimit. Në qoftë se Komisioni jep mendim pozitiv dhe Këshilli njëzëri pajtohet, atëherë formalisht fillojnë negociatat ndërmjet shtetit kandidat dhe të gjitha shteteve anëtare. Shtetet candidate duhet t'i plotësojnë disa kriteret para se ato të bëhen anëtare të BE-së. Kriteret, të cilat duhet t'i plotësojnë, janë si në vijim: dialogun politik dhe ekonomik, Raportet e rregullta/ të progresit, Programi kombëtar për miratimin e legjislacionit evropian; Pjesëmarrja në programet, agjencitë dhe komitetet e BE-së; Bashkëfinancimi nga institucionet financiare ndërkombëtare;

<sup>1</sup> Për me shumë rreth zhvillimit të Bashkimit Evropian shih; Desmond Dinan: *Ever Closer Union? An Introduction to European Integration*, Macmillan 2005

<sup>2</sup> Komisioni Evropian: *Të kuptuarit e Zgjerimit, Politika e zgjerimit e Bashkimit Evropian, Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë 2007*

Asistenca e para-pranimit; Partneritetet e pranimit/partneritetet evropiane dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit<sup>3</sup>.

Për përgatitjet e shteteve kandidatë për anëtarësim, Komisioni, me anë të "raporteve monitoruese" apo të njohura edhe si "raportet e progresit", vazhdimisht njofton Këshillin dhe Parlamentin. Monitorimi, po ashtu, shërben për t'i udhëzuar vendet kandidatë në punët e tyre përgatitore.

Kjo shërben edhe si bazë për masat që do të ndërmerret nga Komisioni dhe veprimet që duhet të i ndërmerret shteti aplikues. Rruga drejt BE-së është e dizajnuar në mënyrë që të përgatiten shtetet për harmonizim të legjislacionit dhe arritjen e standardeve demokratike, politike dhe ekonomike të kërkuara për anëtarësim në BE. Për çdo marrëveshje, me të cilën pranohet një anëtar i ri, kërkohet miratimi unanim i të gjitha shteteve anëtare.

## 2.2 E ardhmja e zgjerimit të BE-së

Zgjerimi i BE-së ndodhi në disa valë dhe etapa të ndryshme, kështu në dhjetor të vitit 2002, Bashkimi Evropian ndërmoi njërin ndër hapat më të rëndësishëm në historinë e integritit evropian. Ajo pranoi t'i bashkoheshin më 1 maj 2004, edhe 10 vende të tjera si Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Lituania, Letonia, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia. Ndërsa Bullgaria dhe Rumania pas një procesi më të gjatë iu bashkuan BE-së më 1 janar 2007. Kurse Kroacia u anëtarësua me 1 Korrik 2013 dhe kështu u rrit numri në 28 shtete anëtare të Bashkimit Evropian.

Procesi i zgjerimit nuk duhet kuptuar thjesht si një shtrirje më e madhe gjeografike e rritje demografike por edhe si konfirmim i paqes dhe demokracisë, si dhe mirëqenies e bashkëpunimit ndërmjet popujve të ndryshëm të Evropës. Reforma institucionale dhe zgjerimi janë dy sfida të mëdha jo vetëm të BE-së por edhe të vet shteteve që aspirojnë anëtarësimin në të. Prandaj kjo kërkon edhe një proces më të gjatë e kompleks të përgatitjes së vendeve kandidatë dhe atyre kandidatë potenciale, në mënyrë që të zbatohen rregullat komunitare, të harmonizohen

ligjet dhe plotësohen kriteret e kërkuara nga Bashkimi Evropian<sup>4</sup>.

## 3. BE-ja dhe integrimi i Evropës Juglindore

Shtetet e Evropës Juglindore si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Kosova gjenden në proces të integritit dhe kanë para vetes detyra të mëdha e të rënda për të e përmblyllur me sukses këtë proces dhe të bëhen anëtarë fuqiptotë të BE-së. Të dala nga regjimi disa dekadash komunist si dhe nga konfliktet e armatosura, kjo shihet si një sfidë e jashtëzakonshme që në këtë regjion të krijohej paqe, të konsolidohej demokracia dhe të ketë ngritje ekonomike. Së këndejmi BE-ja ka luajtur një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në përkrahjen e këtyre vendeve në këtë rrugëtim. Procesi i Stabilizim-Asociimit filloi në maj të vitit 1999, si një zotim afatgjatë i Bashkimit Evropian për t'i ndihmuar vendet e rajonit gjatë procesit të anëtarësimit, përfshirë aspektin politik, financiar dhe të burimeve njerëzore.

### 3.1 Evropa Jug-Lindore pas Selanikut

Këshilli Evropian, në takimin e tij të 19-20 qershorit 2003, adoptoi dokumentin "Agjenda e Selanikut për Ballkanin Perëndimor: Drejt Integritit Evropian." Agjenda e Selanikut u miratua si një dokument i përbashkët i BE-së dhe i këtyre vendeve, ku u theksua që vendet e Evropës Juglindore apo siç u emërtua aty Ballkanit Perëndimor, do të mund të bëheshin pjesë përbërëse Bashkimit Evropian, sapo të përmbushin kriteret përkatëse-bëhet fjalë pra për kriteret e Kopenhagës<sup>5</sup>. Të konfirmuara edhe në konkluzionet e Samiteve të mëhershme në Feira dhe në Zagreb në vitin 2000. Me këtë BE e bëri të qartë se përparimi i integritit në BE do të varet nga puna individuale e vendeve që përfshin një gamë të gjerë të reformave të ekonomive të tyre, standardet e demokracisë, të drejtave të njeriut, e mirëqeverisjes dhe respektit për sundimin e ligjit. Për këtë arsye, Agjenda e Selanikut ishte një hap i rëndësishëm në marrëdhëniet me vendet e regjionit dhe në të

<sup>4</sup> Francois d'Arcy: *Politikat e Bashkimit Evropian, Tirane, Papirus 2007 fq.24ff*

<sup>5</sup> Shihe;

[http://europa.eu.int/comm/external\\_relations/see/gacthess.htm](http://europa.eu.int/comm/external_relations/see/gacthess.htm) (11.11.2013)

<sup>3</sup> Ibid.

njëjtën kohë , ajo u hap perspektivë të re atyre shteteve. Më vonë Këshilli Evropian konfirmoi disa herë se e ardhmja e regjionit është në BE dhe ritheksoi përkushtimin e vet për përkrahje të plotë dhe efektive të perspektivës evropiane për këto vende.

### 3.2 Perspektiva e anëtarësimit në BE

Anëtarësimi i plotë i Kroacisë në BE, duhet të jetë një inkurajim për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor për të ndjekur reformat e tyre. Në anën tjetër liberalizimi i vizave (përjashtim këtu bënë Kosova) sikurse avancimi i statusit dhe procesit të integritit, dëshmon që ka progres në këtë drejtim. Sidoqoftë, tejzgjatja e këtij procesi vjen edhe si rezultat i ngecjeve apo mos përmbushjeve të standardeve të kërkuara pra të kondicionalitetit që del nga BE-ja<sup>6</sup>.

Sundimi i brishtë i ligjit, kushtet e rënda ekonomike e sociale si dhe arritja e standardeve evropiane lidhur me *acquis communautaire*, në fusha e sektor të ndryshme, do të paraqesin edhe për një kohë sfidë të vërtetë për qeveritë e këtyre shteteve, të cilat deri tani nuk kanë dëshmuar gatishmëri dhe aftësi serioze për të i tejkaluar këto pengesa, në mënyrë që të hapin sa më parë perspektiven e qarte për vendet e tyre<sup>7</sup>. Kalimi i shkallëzuar nga statusi i "kandidatit potencial" në "kandidat" dhe përfundimisht në "aderues" është pra proces progresiv e jo akt ose vendim i vetëm politik. Mirëpo, ky progres do të varet edhe nga angazhimi i BE-së që të i shtyjë këto procese përpara<sup>8</sup>.

### 4. MSA dhe Kosova

Bashkimi Evropian me anë të Komisionit Evropian, e themeloi Instrumentin e Asistencës së Para-anëtarësimit- IPA-n (*Instruments of Pre-Accession Assistance*), ku edhe Kosova është pjesë e saj. Qëllimi i këtij mekanizmi në veçanti ishte të ndihmoj forcimin e institucioneve

demokratike dhe zbatimin e ligjit, të reformojë administratën publike, t'i realizojë reformat ekonomike, të promovojë respekt për të drejtat e njeriut, të drejtat e minoriteteve dhe për barazi gjinore, gjithashtu ta mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile, të forcoj bashkëpunimin rajonal, të kontribuojë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe do ta reduktoje varfërinë. Në nëntor të vitit 2002 BE-ja themeloi Mekanizmin Përcjellës të Procesit të Stabilizim-Asociimit për të i asistuar dhe mbështetur financiarisht vendet e Ballkanit perëndimor. Kjo mbështetje është e kushtëzuar me progresin në përmbushjen e Kriteve të Kopenhagës, gjë e cila vlerësohet nga Raporti i Progresit nga Komisioni Evropian. Kështu, bie fjala asistenca e BE-së për Kosovën përmes IPA-s për periudhën 2007 deri 2009 ishte 199.1 milion Euro<sup>9</sup>.

Që nga Samiti i Selanikut, Kosova është e përfshirë në kornizën e Procesit të Stabilizim-Asociimit. Në këtë proces, janë të përfshira edhe Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Ky proces është pjesë e politikës së zgjerimit të BE-së në kuadër të përgatitjes së tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor për integrim në BE.

Procesi i Stabilizim-Asociimit i ka tri qëllime:

- Stabilizimin dhe transformimin e shpejtë në ekonominë e tregut;
- Shtytjen e bashkëpunimit rajonal dhe
- Perspektivën e anëtarësimit në BE<sup>10</sup>.

Ky mekanizëm u ndihmon vendeve të rajonit t'i ndërtojnë kapacitetet e tyre, me qëllim që t'i miratojnë dhe t'i zbatojnë standardet evropiane, duke i përfshirë edhe standardet ndërkombëtare si dhe *Acquis communautaire*, e që i nënkupton të gjitha traktatet, rregulloret dhe direktivat e miratuar nga institucionet evropiane si dhe vendimet e Gjykatës së Drejtësisë. Secili shtet lëviz përpara duke u bazuar në progresin që arrin në përmbushjen e zotimeve, që dalin nga korniza

<sup>6</sup> Shihe; [http://ec.europa.eu/enlargement/the-policy/countries-on-the-road-to-membership/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/the-policy/countries-on-the-road-to-membership/index_en.htm) (11.11. 2013)

<sup>7</sup> Për një trajtim mjaft informues e argumentues të këtij procesi shihe; Adam Fagan: *Europe's Balkan Dilemma. Paths to Civil Society or State-Building?* I.B.Tauris, London 2010, fq.18-48

<sup>8</sup> Një analizë mjaft interesante dhe aktuale ofron Qendra Evropiane e Politikave, shih; Corina Stratulat: *EU enlargement to the Balkans: shaken, not stirred.* EPC, Policy Brief, 4 November 2013

<sup>9</sup> Venera Hajrullahu: *Gjendja aktuale dhe sfidat kryesore për Kosovën drejt rrugës së anëtarësimit në Bashkimin Evropian.* FES-Conference Paper, Prill 2008 fq.9

<sup>10</sup> [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu\\_kosovo/politika/\\_relations/stabilisation\\_and\\_association\\_process/index\\_sq.htm](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu_kosovo/politika/_relations/stabilisation_and_association_process/index_sq.htm) (14.11.2013)

e PSA-së. Çdo vit, në raportet vjetore, Komisioni Evropian e vlerëson përgatitjen e shteteve të Ballkanit Perëndimor për të lëvizur më afër drejt Bashkimit Evropian. Qasja i e BE-së është që politikat e zgjerimit të menaxhohen me kujdes dhe në mënyrë graduale. Zgjerimet e reja do të bëhen me shtetet e Evropës Juglindore. Këto shtete janë në nivele të ndryshme të rrugës së tyre për në Evropë. BE-ja vazhdimisht ka rikonfirmuar në nivelet më të larta angazhimin e saj për perspektivën evropiane të Evropës Perëndimore, po qe se ajo i përmbush kriteret e pranimit.

Fushat e bashkëpunimit rajonal janë ndër tjerash në këto fusha si; bashkëpunimi politik, tregtia dhe investimi, tregtia e lirë (CEFTA), klima investuese, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, zhvillimi i infrastrukturës, energjia, transporti, mjedisi, arsimi, siguria dhe liria e lëvizjes, menaxhimi dhe kontrollimi i integruar i kufijve, lufta kundër krimit ndërkufitar dhe korrupsionit etj.

#### 4.1 MSA, Mundësi dhe Sfidë

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është proces i dyanshëm dhe proces rajonal, me të cilin krijohen marrëdhëniet ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore dhe të BE-së dhe, në të njëjtën kohë, nxitet bashkëpunimi ndërmjet vendeve të rajonit. Mekanizmi Përcjellës i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim (MPSA) është baza për dialogun e rregullt mes BE-së dhe autoriteteve kosovare mbi çështjet e BE-së<sup>11</sup>. Përveç kësaj, u themelua një strukturë e re e grupeve punuese sektoriale nën ombrellën e MPSA-së në fushat si të qeverisjes së mirë, ekonomisë, tregut të brendshëm, inovacionit, infrastrukturës dhe bujqësisë.

Në këtë kuptim, "Plani i Veprimit përdoret për planifikimin e veprimtarisë së Qeverisë: në lidhje me agjendën politike të Qeverisë dhe prioritetet e saj, agjendën legjislative të Qeverisë (ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe akte tjera ligjore) si dhe Parlamentit, planin e punësimit të nevojshëm për zbatimin e agjendës së integrimi evropiane dhe zbatimin e akteve të harmonizuara ligjore, planin për ndërtimin institucional dhe trajnimin e personelit (nevojat

për trajnime të përgjithshme dhe specifike), dhe planin për investime e sidomos për ndërtimin (avancimin) e rrjetit të TI në lidhje me Acquis"<sup>12</sup>. Qysh në vitin 2008 Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian e parasheh që të fillojë reforma në administratën publike – reformë e cila do të bazohet në tri dokumente: 1. Raporti për gjendjen e Administratës Publike në Kosovë, 2. Strategjia për Reformën e Administratës Publike në Kosovë si dhe 3. Plani i Veprimit të Reformës së Administratës Publike në Kosovë. Ky plan parashikon që administrata publike të jetë profesionale, të ketë strukturë të organizmit, menaxhim cilësorë, transparent, komunikim efektiv me qytetarët, etj. Që nga viti 2010 Ministria e Integritetit Evropian ka lansuar dhe funksionalizuar sistemin elektronik për monitorim dhe raportim të PVPE-së. "Gjatë 2011 ky sistem është shfrytëzuar për përpilimin e raporteve në baza tremujore nga secili institucion bartës i veprimeve konkrete në kuadër të PVPE 2010 dhe PVPE 2011. I njëjti sistem do të përdoret edhe gjatë vitit 2012 për monitorimin e implementimit të PVPE si dhe për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të dala nga Dialogu i Procesit të Stabilizim-Asociimit"<sup>13</sup>. Raporti i PVPE për vitin 2012 thekson se prioritet dhe punë e madhe e pret në sektorin e reformës së administratës publike sikurse edhe te sundimi i ligjit<sup>14</sup>. Në tetor 2012, Kosova mori Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Ky studim përmban rekomandimet afatshkurtra dhe afatmesme dhe gjithashtu prioritetet që ndërlidhen me kriteret politike, kriteret ekonomike, administrative, si dhe punën që i pret institucionet tona rreth përmbushjes së këtyre kriterëve. "Pjese e kriterëve politike përfshihen: reforma në administratën publike, të drejtat e njeriut, mbrojtja e minoriteteve etj. Ndërsa kriteret ekonomike përfshijnë: përmirësimin e ambientit biznesor, krijimin e vendeve të punës, zhvillimi i ekonomisë lokale, etj. Sipas Komisionit Evropian, Republika e Kosovës është shumë e gatshme për të hapur negociata për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, por vetëm nëse Kosova i ndërmerr hapat e paraparë në rekomandime dhe prioritetet

<sup>12</sup> Qeveria e Kosovës. Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian 2008. Prishtinë, Korrik 2008. fq. 10

<sup>13</sup> Qeveria e Kosovës. Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian 2012. Prishtinë, Dhjetor 2011. fq. 7

<sup>14</sup> Po aty., fq.8

<sup>11</sup> Hajrullahu op.cit., fq.8-10.



si: sundimi i ligjit, administrata publike, të drejtat themelore të njeriut, mbrojtja e minoriteteve dhe tregtia.”<sup>15</sup>

Në tetor të këtij viti u hapën negociatat për Marrëveshjen Stabilizim-Asociimi në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Qëllimi i së cilës është ofrimi i kornizës politike dhe ligjore që do të rregullonte procesin e përafrimit dhe anëtarimit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim, me 27 shkurt, Qeveria e Republikës së Kosovës ka themeluar ekipin negociator që udhëhiqet nga Ministria e Integritimit Evropian të organizuar në 3 grupe punuese, e që janë; grupi punues për çështje tregtare; grupi punues për përafrim të legjislationit si dhe grupi punues për politikën e bashkëpunimit. Negociatat do të zhvillohen dhe tashmë formalisht kanë filluar të zhvillohen sipas kapitujve negociues dhe fillimisht do të negociohen çështjet e lirisë së mallrave, pastaj harmonizimit të legjislationit dhe në fund do të negociohen politikën e bashkëpunimit. Këto negociata do të paraqesin një sfidë të re por edhe mundësi të mirë për qeverinë e vendit që të thellojë agjendën e reformave si dhe përafroj Kosovën në procesin e integritimit. Por qeveria e Kosovës duhet të bashkëpunojë edhe me shoqërinë civile, komunitetet e bizneset dhe akademike, në mënyrë që të gjej modelet më të përshtatshme të zbatimit.

#### 4.2 Integritimi me shumë të panjohura

Kosova, për shkak të statusit të pazgjidhur politik e juridik për një kohë të gjatë, dhe rrethanave të tjera si mosnjohja nga pesë shtete anëtare të BE-së dhe relacionet me Serbinë, ka hyrë më së voni në procesin e integritimit nga të gjitha vendet e Evropës Juglindore. Arritja e marrëveshjes së Prillit me Beogradin për normalizim të marrëdhënieve, zbutja e qëndrimeve të pesë vendeve të BE-s që nuk e kanë njohur Kosovën, sikurse edhe përkushtimi më i shtuar i qeverisë ka bërë, që kohëve të fundit të shënohen disa përparime në këtë drejtim. Mirëpo, siç u cek edhe më parë Kosova në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit qëndron ende larg në këtë proces. Kështu, bie fjala ajo është e vetmja e cila

nuk ka përfituar nga liberalizimi i vizave edhe pse që nga Janari i viti 2012 është në bisedime me BE-në për këtë çështje.

Në anën tjetër prania e BE-së në Kosovë që nga paslufta në formë të ndryshme, ka bërë që Kosova të jetë një nga përfituesit më të mëdhenj të ndihmave financiare dhe asistencës teknike për kokë banori. Që nga viti 1999 deri më 2007 BE-ja ka shpenzuar rreth dy miliard euro për Kosovën dhe që nga 2008 mbi 65 milion çdo vit përmes fondeve të IPA-së<sup>16</sup>. Mbështetjet e cila siç po duket nuk ka qenë e duhur për të rritur zhvillimin ekonomik dhe forcuar sundimin e ligjit, në këto dy sfera ku Kosova ka ngecje serioze në përmbushjen e kriterëve për përafrim dhe aderim në BE. Së këndejmi ka studiues të cilët pohojnë se politika e kondicionalitetit (kushtëzimit) e BE-së nuk ka rezultuar edhe shumë efikase pasi që nuk ka arrit rezultate të pritura<sup>17</sup>.

Por procesi i integritimit varet në masë të madhe edhe nga vet niveli i demokracisë së vendeve aspiruese, stabiliteti politik si dhe nga përkushtimi i qeverive dhe elitave politike që këtë proces të shtyjnë përpara pavarësisht interesave partiake e luftës për pushtet. Një kontribut të çmueshëm këtu mund të jap edhe shoqëria civile si dhe bota akademike.

#### 5. Konkluzione dhe Rekomandime

Bashkimi Evropian është aktor i rëndësishëm në rajon dhe donatori më i madh i Kosovës, i cili ndan më shumë mjete për kokë banori në Kosovë sesa në secilin vend të botës, mirëpo procesi i integritimit të Kosovës nuk ka dhënë edhe rezultate aq të lakmueshme. Arsyet për këtë janë edhe të jashtme, për shkak të politikave jokohërente dhe joefikase të vet BE-së ndaj Ballkanit dhe Kosovës, por në masë më të madhe për shkak të paafësisë së qeverive të vendit që të i arrijnë standardet e kërkuara. Në këtë analizë të shkurtë të procesit të integritimit Evropës Juglindore në BE, u përshkrua jo vetëm trajektorja e këtij procesi por edhe sfidat të cilat dalin gjatë këtij procesi mjaft kompleks. Që nga samiti i Selanikut e tutje, duke shtjelluar progresin por edhe ngecjet.

<sup>15</sup> Alising Lyon. *Prezentimi i Raportit të Fizibilitetit. Projekti i BE për komuna më të fuqishme, Komisioni Evropian në Kosovë, Prishtinë, Tetor 2012*

<sup>16</sup> Fagan op.cit., fq.161

<sup>17</sup> Po aty, fq. 190ff.

Gjithashtu, doli në pah se procesi i integritimit të Kosovës është mjaft i vonuar në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe se kërkohen një bashkëpunim më i madh jo vetëm me institucionet e BE-së por edhe të Ballkanit. Në kuadër të bashkëpunimi rajonal, vendet duhet t'i promovojnë objektivat dhe nismat konkrete në përputhje me agjendën e Selanikut në fushën e liberalizimit të tregtisë rajonale, lëvizjen e lirë dhe pa viza në rajon, mbledhjen e armëve të vogla, zhvillimin e transportit, krijimin e tregjeve rajonale për energjetikë dhe gaz, zhvillimin e infrastrukturës energjetike dhe të telekomunikacionit, mbrojtjen e ambientit dhe menaxhimin e ujërave, kërkime dhe zhvillim, bashkëpunimin ndërkufitar dhe parlamentar.

Në këtë studim theksi bie sidomos mbi negociatat e Kosovës për arritjen e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit si dhe ndikimit që mund të ketë kjo më pas në integrimin evropian. Meqë është ende herët të parashikohen pasojat e këtij procesi, MSA u analizua nga këndi i sfidave potenciale por edhe mundësive që ofron kjo marrëveshje për vendin. Politika e kushtëzimit (kondicionaliteti) nënkupton që masat e BE-së do të zbatohen në mënyrë progresive dhe do të varen nga progresi që do të arrihet në Kosovës. Së këndejmi, rekomandohet:

- Që qeveria e Kosovës të angazhohet fuqishëm në arritjen e objektivave të parapara në fushat e caktuara, si reformat në administratë publike, forcimin e sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, krijimi i ambientit më të mirë për biznese e treg të lirë etj.
- Kërkohet që në bashkëpunim me sektorët e bizneseve, odat ekonomike dhe qarqet akademike të bëhen edhe përlogaritjet ekonomike nga MSA-ja, si dhe masat që duhen ndërmarrë me këtë rast.
- Bashkërendim i institucioneve qeveritare dhe atyre jo-qeveritare të shtohet në masë të konsiderueshme, në mënyrë që edhe zbatimi i marrëveshjeve të arritura të jetë sa më mirë e më parë i mundshëm.
- Llogaridhënia e institucioneve përkatëse për arritjen si dhe zbatimin e kapitujve të marrëveshjes duhet të jetë në nivel të lartë përgjegjësie.

- Të rriten kapacitetet absorbuese të fondeve të BE-se (IPA-së) dhe ato të shfrytëzohen për të arritur rezultate të qëndrueshme.
- MSA të shërbej edhe për përsheptimin e procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën.
- Si dhe përfundimisht, MSA të mos jetë vetëm një marrëveshje formale, por hap i radhës në rrugëtimin e Kosovës drejt BE-së duke dëshmuar përkushtim dhe vullnet politik për të përmbushur kriteret dhe standardet evropiane në këtë proces.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë punim janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

#### Kontakti:

**Konrad-Adenauer-Stiftung**  
 Zyra në Kosovë  
 Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6  
 KO-10000 Prishtinë  
 Telefon +381 (0) 38 229 874  
[Prishtina@kas.de](mailto:Prishtina@kas.de)  
[www.kas.de/kosovo](http://www.kas.de/kosovo)